



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë OT LOGISTICS SPÓŁKA AKCYJNA nga shoqëritë Auctor Holding, a.s. dhe SPV Second a.s., nëpërmjet shoqërisë DD Rail Properties a.s.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 56 prot., i AK, datë 19.01.2026, “Kërkese për konsultim”, ku jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi blerjen e 49% të kapitalit të shoqërisë OT LOGISTICS SPÓŁKA AKCYJNA nga shoqëritë Auctor Holding, a.s. dhe SPV Second a.s.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

Blerësi: DD Rail Properties a.s. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Republikës Çeke, i cili kontrollohet në mënyrë të përbashkët nga Auctor Holding, a.s. (përmes Auctor Alfa, a.s.) dhe SPV Second a.s. DD Rail Properties është një shoqëri me qëllim të veçantë (SPV) aktive në menaxhimin e pronës, qiradhënie e pasurive të paluajtshme, apartamenteve dhe hapsirave komerciale.

Auctor Holding, a.s. është një shoqëri kryesisht aktive në shërbimet e hotelerisë dhe industrisë së kujdesit shëndetësor, e cila nuk është prezent dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

SPV Second a.s. ka si objekt veprimtarie menaxhimin e pronës, qiraja e pasurive të paluajtshme, apartamenteve dhe ambienteve jo-rezidenciale dhe realizon të ardhura në Shqipëri nga shoqëritë e grupit.

Shitësit: Cres Fundacja Rodzinna, Marsel Fundacja Rodzinna dhe Neuvic Fundacja Rodzinna, fondacione familjar që ekzistojnë në bazë të ligjeve të Republikës së Polonisë.

Target: OT LOGISTICS SPÓŁKA AKCYJNA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Polonisë, me objekt aktiviteti: nxjerrja e zhavorrit, rërës, argjilës dhe kaolinit; veprimtaria mbështetëse për minierat dhe nxjerrjen e mineraleve; prodhimi i produkteve të formuara në të ftohtë; prodhimi i strukturave metalike dhe pjesëve të tyre; prodhimi i anijeve civile dhe strukturave lundruese; prodhimi i anijeve turistike dhe sportive etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.